



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2022:149614

Datë: 15.02.2024

Numri i dokumentit: 05440672

P.nr.218/22

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEGA NË ISTOG, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, Gjyqtari i vetëm gjykues Petrit Nrecaj, në çështjen penale kundër të pandehurit R.D për shkak të veprës penale mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve finaciare nga neni 430 par.2 të Kodit Nr.06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (tutje KPRK), i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm me numër PP.II.nr.1380/22 të datës 29.07.2022, duke vendosur përkitazi me kërkesën për hedhjen e aktakuzës të parashtruar nga mbrojtësi i të pandehurit R.D, av.Shkodran Manaj, jashtë seancës me datë 15.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET** kërkesa për hudhjen e aktakuzës, e parashtruar nga mbrojtësi i të pandehurit R.D, av.Shkodran Manaj, ashtu që:
HUDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.1380/22 të datës 29.07.2022, dhe **PUSHOHET** procedura penale ndaj të pandehurit R.D, nga i ati A. dhe e ëma H., e gjinisë S., i lindur me datë ... në fshatin V., ku dhe jeton në, Komuna I., pensionist, ish Këshilltar i Asamblesë Komunale të Istogut, me gjendje të mesme ekonomike, me numër personal ...1, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i akuzuar për shkak të veprës penale *mosraportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve finaciare nga neni 430 par.2 të KPRK-së*.
- Për shkak se vepra penale për të cilën akuzohet, nuk përbën vepër penale.
- II.** Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykatë.
- III.** Pala e dëmtuar: Agjencia Kundër Korrupsionit me seli në Prishtinë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm, në këtë gjykatë ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.1380/22 të datës 29.07.2022, kundër të pandehurit R.D, për shkak të veprës penale mosraportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve finaciare nga neni 430 par.2 të KPRK-së (i cili cilësim juridik i veprës penale është përmirësuar ne seancën e mbajtur fillestare me datë 18.12.2023).

Gjykata duke vepruar sipas aktakuzës, ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 18.12.2023, ku pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit, i pandehuri R.D është deklaruar i pa fajshëm për veprën penale e cila i vihet në barrë, pastaj gjykata të pandehurin dhe mbrojtësin e tij, i ka udhëzuar për të drejtat e parapara me nenin 243 dhe 244 të KPP-së.

Mbrojtësi i të pandehurit R.D av.Shkodran Manaj, me datë 21.12.2023 (data e dorëzimit ne postë), brenda afatit, ka parashtruar kërkesë për hudhjen e aktakuzës në këtë çështje penale, për shkak se vepra për të cilën akuzohet i mbrojturi i tij, nuk përbën vepër penale, ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë penale.

Gjykata, e ka njoftuar ne mënyrë të rregullt prokurorinë me kundërshtimin e provave dhe kërkesën për hudhje të aktakuzës të parashtruara në këtë çështje penale si më lartë. E cila deri në ditën e marrjes së këtij aktvendimi nuk është përgjigjur.

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës me rastin e vendosjes lidhur me kërkesën për hudhje të aktakuzës te parashtruar nga mbrojtësi i të pandehurit R.D, av.Shkodran Manaj, ka gjetur se :

- *kërkesa për hudhje të aktakuzës është e bazuar, sepse:*

Mbrojtësi i të pandehurit R.D, av.Shkodran Manaj në kërkesën për hudhjen e aktakuzës, ka theksuar se me ligjin e ri – Ligji për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe te Dhuratave Nr. 08/L-108, i cili është ne fuqi nga data 10 Shkurt 2023, me te cilin janë shfuqizuar ligjet e mëparshme, Ligji Nr. 04/L-050 dhe Ligji Nr. 04/L-228, nuk është parashikuar detyrimi ligjor i deklarimit te pasurisë për Këshilltarin e Asamblesë Komunale (Anëtarin e Kuvendit te Komunës), përkatësisht me nenin 4 dhe 5 te ligjit ne fjale, Këshilltari i Asamblesë Komunale nuk konsiderohet me as zyrtar i lartë e as zyrtar publik, te cilët sipas Ligjit janë te obliguar te deklarojnë pasurinë e tyre me rastin e ushtrimit te funksionit publik, e rrjedhimisht tanimë kjo nuk përbën vepër penale ne kuptim te nenit 430 te KPRK-se. Prandaj, duke marre parasysh këtë rrethane, e cila përbën pengese ligjore për vazhdimin e ndjekjes penale bazuar ne parimin e zbatimit te ligjit me te favorshëm për te pandehurin, i garantuar me nenin 3 paragrafin 2 te KPRK-se. Nga këto arsye, ka propozuar që të hudhet aktakuza dhe të pushohet procedura në këtë çështje penale ndaj te mbrojturit te tij.

Prokuroria në përshkrimin faktik të veprës penale për të cilën akuzohet i pandehuri ka theksuar se: i pandehuri R.D, me datën 31.03.2021 në Istog si zyrtar publik me obligim ligjor të deklarimit të pasurisë, të të ardhurave, të dhuratave, të dobisë tjetër pasurore ose të detyrimeve financiare, përmes Formularit për Deklarim të pasurisë, në të njejtin të protokolluar me nr. protokollit 03-4361/21 pranë AKK me datën 31.03.2021, nuk ka paraqit të dhënat e kërkuara me ligj, në atë mënyrë që: *në kohën dhe vendin e lartëcekur gjatë përpilimit dhe dorëzimit në AKK të formularit për deklarim të pasurisë për vitin 2020 nuk e ka deklaruar biznesin dhe të ardhurat nga ai biznes për vitin 2020 në shumën prej tetë mijë e katërqind e pesëdhjetë e nëntë euro e gjashtëdhjetë e dy cent (8459,62) për biznesin “Euroteks Shpk” me numër të biznesit 810103604 me seli në fsh. Vrellë-Istog e themeluar me datën 15.04.2016 dhe aktive, me aksionar/ të pandehurin dhe bashkëshorten e tij S.D si anëtare e familjes së tij sipas ligjit në fuqi.*

Gjykata nga përmbajtja e aktakuzës, kallëzimit penal dhe provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës siç janë Formulari për Deklarimin e Pasurisë për këtu të pandehurin R.D në vitin 2021, ka vërtetuar faktin se: këtu i pandehuri R.D, nga data 28.03.2019 edhe ditën kritike me datë 31.03.2021, ka pasur funksionin-poziten e Këshilltarit në Asamblenë Komunale në Kuvendin Komunal në Istog.

Sipas nenit 430 par.2 të Kodit Penal të Kosovës, përcaktohet se veprën penale mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare, e kryen: **“Çdo person, i cili sipas ligjit është i detyruar të bëjë deklarimin e pasurisë, të të ardhurave, të dhuratave, të dobisë tjetër pasurore ose të detyrimeve financiare, i cili bën deklaratë të rreme ose nuk paraqet të dhënat e kërkuara në deklaratë, dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet. Gjobat e shqiptuara sipas këtij neni mund të jenë ditore dhe mund të shqiptohen derisa kryesi të përfill urdhrin, vendimin apo aktgjykimin e plotfuqishëm që është subjekt i veprimit”.**

Sipas Ligji nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të Gjithë Personat Zyrtarë, i cili ka qenë në fuqi nga data 14.11.2011 deri me datë 01.02.2023, përkatësisht i cili ka qenë në fuqi në kohën e ngritjes së kësaj aktakuze, në nenin 2, është përcaktuar se : “Ky ligj rregullon, procedurën e deklarimit dhe kontrollin e pasurisë, të hyrat dhe detyrimet e zyrtarëve të lartë publik [...]”, ndërsa neni 3 par. 1, nënpar 1.1.8 të këtij Ligji, është përcaktuar se zyrtar të lartë publik janë edhe “**Kryetarët e Komunave dhe Zëvendës Kryetarët, Kryesuesit, Zëvendës Kryesuesit, Këshilltarët e Asambleve Komunale si dhe të gjithë Drejtorët e Drejtorive Komunale**”.

Ndërsa sipas Ligji nr. 08/L-108 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të dhuratave, i cili është në fuqi nga data 01.02.2023, në nenin 36, përcaktohet se, me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohet ligji i sipërcituar: Ligji Nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë Personat Zyrtarë. Ndërsa sipas nenit 4 dhe 5 të këtij Ligji,

ku janë të listuar Zyrtarët e Lartë dhe Zyrtarët Publik, të cilët janë të obliguar të deklarojnë pasurinë e tyre sipas këtij Ligji, *rezulton se “Këshilltarët e Asambleve Komunale”, nuk janë të listuar dhe as nuk kanë obligim ligjor të deklarojnë pasurinë e tyre.*

Sipas nenit 7 par 1. dhe 2 të KPP-së, përcaktohet se: “Gjykata, Prokurori i shtetit dhe Policia të cilët marrin pjesë në procedurën penale detyrohen që saktësisht dhe tërësisht t’i vërtetojnë faktet të cilat janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm; Sipas dispozitave të parapara me këtë Kod, gjykata, prokurori i shtetit dhe policia që marrin pjesë në procedurë penale detyrohen që me vëmendje dhe me përkushtim maksimal, profesional dhe me përkujdesje të njëjtë të vërtetojnë faktet kundër të pandehurit si dhe ato në favor të tij, dhe para fillimit të procedurës dhe gjatë zhvillimit të saj t’i mundësojnë të pandehurit dhe mbrojtësit të tij shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të të pandehurit”.

Ndërsa sipas nenit 3 par.2 të KPRK-së, zbatimi i ligjit më të favorshëm, përcaktohet se zbatohet në rastin kur: “ *Në rast se ligji në fuqi ndryshon para shqiptimit të vendimit të formës së prerë, atëherë ndaj kryesit zbatohet ligji që është më i favorshëm*”.

Gjykata nga të lartcekurat dhe dispozita ligjore e sipërcituar më lartë e nenit 3 par.2 të KPRK-së, thekson se ka për detyrim të zbatoj ligjin më të favorshëm për të pandehurin, në rast se para marrjes së vendimit ka ndryshuar ligji, dhe kur ligji vlerësohet më i favorshëm për të pandehurin.

Në këtë drejtim, me rastin e vendosjes në këtë çështje penale, gjykata ka për obligim të zbatoj Ligji nr. 08/L-108 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të dhuratave, i cili është në fuqi nga data 01.02.2023, i cili është ligj me i favorshëm në raport me të pandehurin sepse me dispozitat e këtij ligji, Zyrtarët e Lartë në pozitën “Këshilltarët e Asambleve Komunale” të cilën pozitë të punës e kishte edhe këtu i pandehuri në kohën kryerjes së veprës penale e cila i vihet në barrë sipas akuzës, tani me këtë Ligj, pozitat e tilla “Këshilltarët e Asambleve Komunale”, nuk kanë obligim ligjor që të bëjnë fare deklarimin e pasurisë apo dhuratave. Rrjedhimisht mosdeklarimet apo deklarimet e pa vërteta të cilat janë bërë nga “Këshilltarët e Asambleve Komunale” për të cilat veprime sipas Ligji nr. 04/L-050, janë ngritur kallëzime penale dhe pastaj edhe aktakuza, por të cilat çështje nuk kanë përfunduar me vendim të formës së prerë, tani sipas këtij Ligji nr. 08/L-108, nuk inkriminohen sepse “Këshilltarëve të Asambleve Komunale” ju është hequr obligimi për të deklaruar pasurinë. Gjithashtu, gjykata në këtë rast duhet të zbatoj ligjin më të favorshëm edhe për faktin se ndaj këtu të pandehurit nuk ka përfunduar me vendim të formës së prerë, procedura penale për veprën penale për të cilën akuzohet.

Gjykata pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës dhe dispozitat ligjore të sipërcituara, ka ardhur në përfundim se meqenëse ka ndryshuar-është shfuqizuar Ligji nr. 04/L-050, i cili ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale dhe tani ligji i ri Ligji nr. 08/L-108, është më i favorshëm për të pandehurin, dhe si i tillë konform nenit 3 par.2 të KPRK-së, duhet të zbatohet. Nga çka rezulton se është e bazuar kërkesa e mbrojtësit të pandehurit për hudhjen e aktakuzës dhe pushimin e procedurës penale ndaj të mbrojturit të tij, sepse nga veprimet e të pandehurit të

përshkruara në përshkrimin faktik të veprës penale, tani sipas ligjit të ri (Ligji nr. 08/L-108) këto veprime, nuk e përbëjnë figurën e veprës penale mosraportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve finaciare nga neni 430 par.2 të KPRK-së. Prandaj e ka hedhur aktakuzën dhe ka pushuar procedurën në këtë çështje penale konform nenit 248 par.1 nënpar.1.1 të KPP-së, si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë konform nenit 453 KPP-së.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesave pasurore juridike në kontest civil, është marr konform nenit 457, 462 par.3 të KPP-së.

Nga arsyet e lartë cekura, e ne bazë të nenit 248 par.1 nënpar.1.1 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEGA ISTOG
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Petrit Nrecaj

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese, brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë. *Në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palët.*